

Fjalor

Përkufizimet e paraqitura më poshtë kanë të bëjnë me mënyrën se si përdoren këto terma në Matjen e Aftësisë Ripërtëritëse për Përmbytjet në Komunitete (FRMC). Përkufizimet janë zhvilluar nga partnerët e Aleancës së Zyrihut për Aftësinë Ripërtëritëse për Përmbytjet nga burime të ndryshme, përfshirë terminologjinë e UNISDR.



In partnership with:



Të dhënat e burimeve dytësore: Të dhënat që janë mbledhur tashmë dhe janë në dispozicion. Kjo mund të përfshijë: informacione nga projekte të mëparshme ose organizata të tjera, të dhëna regjistrimesh, grupe kombëtare ose ndërkombëtare të të dhënave përfshirë. të dhëna qeveritare, online dhe offline.

4R: Secili burim i aftësisë ripërtëritëse i është caktuar një prej 4 R-ve, ose vetive të një sistemi të aftë për ripërtëritje. Kjo qasje e "analizë e sistemeve" merr parasysh cilësinë e jetës, ndërveprimet dhe ndërlidhjet në nivel komuniteti. 4R-të janë: qëndrueshmëria, mundësitë, grupet e gatshme dhe shpejtësia.

5C: Secili burim i aftësisë ripërtëritëse i është caktuar njërit prej pesë kapitaleve (5C). 5C-të që karakterizojnë komunitetet janë forma plotësuese të kapitalit që mbajnë dhe mund të ndihmojnë në përmirësimin e mirëqenies së banorëve. 5C-të sigurojnë një pamje holistike të aftësisë ripërtëritëse të një komuniteti. Qasja e shumëfishtë e kapitalit është popullarizuar nga korniza e njohur dhe e përdorur si Mjetet e Jetesës së Qëndrueshme (DFID). Duke eksploruar aftësinë ripërtëritëse ndaj përmbytjes në këtë mënyrë, ne po nxjerrim në mënyrë të qartë lidhjet midis matjes së aftësisë ripërtëritëse ndaj përmbytjes dhe zhvillimit të aftësive në tërësi. 5C-të janë fizike, financiare, njerëzore, sociale dhe natyrore.

Të prekurit: Njerëzit që preken, direkt ose indirekt, nga një ngjarje e rrezikshme. Të prekur drejtpërdrejt janë ata që kanë pësuar lëndime, sëmundje ose efekte të tjera shëndetësore; të cilët ishin evakuuar, zhvendosur, strehuar në vendbanim tjetër ose kanë pësuar dëmtime të drejtpërdrejta të mjeteve të tyre të jetesës, aseteve ekonomike, fizike, sociale, kulturore dhe mjedisore. Të prekur në mënyrë indirekte janë njerëzit që kanë pësuar dëme, pjesë e efekteve të drejtëpërdrejta ose përveç efekteve të drejtëpërdrejta, të shtrira në kohë, për shkak rënive apo ndryshimeve në ekonomi, infrastrukturë kritike, shërbimeve jetike, tregti ose punë, pasoja sociale, shëndetësore dhe psikologjike.

Asetet: Ndërtesat, përmbajtjet, asetet prodhuese (përfshirë pajisjet, makineritë dhe automjetet), toka dhe infrastruktura.

Baza : Aplikimi i FRMC në një komunitet. Shikoni gjithashtu (T-line).

Basen: Basen lumi ose kanali kullues është zona e tokës e përcaktuar nga pikat më të larta, në të cilën e gjithë shiu bie kullon gjatë pjerrësisë së saj der në të njëjtën dalje kryesore (një lumë i madh, liqen ose det), baseni përshkohet nga shumë përrenj dhe lumenj që rrjedhin tatëpjetë në njëri-tjetrin, dhe përfundimisht derdhen në të njëjtën pikë. Baseni mund të mendohet se vepron si një hinkë, duke mbledhur të gjithë shiun që bie dhe duke e kanalizuar atë përmes tokës dhe kanaleve ujorë, në një dalje. Ndonjëherë termat basen lumor ose ujëmbledhës përdoren në mënyrë të njëjtë me basenin ujëmbledhës.

Kapaciteti: Aftësia për të bërë një gjë specifike, e cila kërkon të kesh njohuritë, aftësitë dhe burimet e duhura.

Kapitali : Shiko 5C-t

Dështimet në Kaskadë: Kur dështimet në një sistem çojnë në një seri dështimesh në të njëjtin sistem ose në sisteme të tjera. Për shembull, dështimet në një sistem të energjisë elektrike mund të çojnë në dështime në të gjithë sistemet ose në një sërë

sistemesh që mbështeten në funksionimin e energjisë elektrike, duke përfshirë trajtimin e ujit, komunikimin, transportin, etj.

Fëmijë / Fëmijët : Personat nën 15 vjeç konsiderohen fëmijë në shumë pjesë të aplikacionit, për shembull sondazhet në familje nuk mund të administrohen tek njerëzit nën 15 vjeç. Personat midis 15 dhe 21 vjeç mund të konsiderohen fëmijë në varësi të kontekstit: në disa komunitete njerëzit nën 18 konsiderohen fëmijë, por në bashkësitë e tjera ajo mund të jetë person nën 16 vjeç. Prandaj, kjo mund të përcaktohet rast pas rasti nëse nuk thuhet ndryshe në mënyrë të qartë.

Përmbytjet bregdetare: Përmbytjet bregdetare janë përmbytja e zonave tokësore përgjatë bregdetit nga uji i detit. Shkaqet e zakonshëm të përmbytjeve bregdetare janë batica e lartë, tsunami dhe vale stuhish.

Zona bregdetare: Zona midis tokës dhe detit, e përcaktuar si pjesë e tokës e prekur nga afërsia e saj me detin, dhe pjesa e detit e prekur nga afërsia e saj me tokën.

Konteksti i nivelit të komunitetit: Brenda sferës së ndikimit të komunitetit, aspektet mbi të cilat komuniteti ka kontroll të drejtpërdrejtë, për shembull njohuritë e ndihmës së shpejtë.

Komuniteti: Një "komunitet" mund të përcaktohet gjeografikisht (ndoshta në kontekste rurale) ose nga kufijtë administrativë (të cilët mund të funksionojnë në situata më urbane). Sidoqoftë, asnjë komunitet i vetëm nuk është si një tjetër dhe mund të ketë aspekte kulturore gjithashtu për t'u marrë parasysh. Si rezultat kemi arritur në përfundimin se kur bëhet fjalë për realitetin e terrenit, një komunitet kryesisht e përcakton vetveten.

Konteksti: Secili burim është i lidhur me njërin nga dy konteksteve. Ky dallim mund të ndihmojë në hartimin e ndërhyrjeve, sepse do të nxjerrë në pah se në cilin nivel duhet të synohen ndërhyrjet ose avokacitë. Të dy kontekstet janë niveli i komunitetit dhe mjedisi i mundshëm.

Plani gatishmërisë: Një proces menaxhimi që analizon rreziqet e katastrofës dhe vendos rregullime paraprakisht për të mundësuar përgjigje në kohë, efektive dhe të përshtatshme.

Përballimi: Aftësia e njerëzve, organizatave dhe sistemeve, për të përdorur aftësitë që zotërojnë dhe kapacitetet që kanë për të menaxhuar kushte të pafavorshme, rreziqe ose katastrofa përmbytjesh. Kapaciteti për të përballuar kërkon ndërgjegjësim të vazhdueshëm, kapacitete dhe menaxhim të mirë, si në kohë normale ashtu edhe gjatë fatkeqësive ose kushteve të pafavorshme.

Ulja e rrezikut nëpërmjet korigjimeve : Veprimet e ndërmarra për të zvogëluar rrezikun ndaj asetëve tashmë të rrezikuara, të tilla si nivelet e ndërtimit, duke tentuar për të mbrojtur më mirë pasuritë ekzistuese ose rikonceptuar ndërtimet e aplikuara në një shtëpi në mënyrë që t'i rezistojë më mirë përmbytjeve, etj.

Infrastruktura kritike: Strukturat fizike, objektet, rrjetet dhe asetet e tjera që ofrojnë shërbime që janë thelbësore për funksionimin social dhe ekonomik të një komuniteti ose shoqërie.

Ndikimi i drejtpërdrejtë: Ndikimet përmes një ndërveprimi të drejtpërdrejtë ku përfshijnë shok psikologjik, stresin, komponentet fizike, ekonomik, shoqëror ose politik. Në rastin e përmytjes, kjo përfshin njerëzit e lënduar ose të vdekur, shtëpitë e dëmtuara dhe infrastruktura të shkatërruara për shkak të ujërave të përmytjes.

Cikli i menaxhimit të rrezikut nga katastrofa (DRM): Procesi sistematik i përdorimit të direktivave administrative, organizatave dhe aftësive operacionale dhe kapaciteteve për të zbatuar strategji, politika dhe kapacitete të përmirësuara të përballimit në mënyrë që të zvogëlohen ndikimet e pafavorshme të rreziqeve dhe mundësia e një katastrofe që mund të ndodhë. Menaxhimi i rrezikut nga katastrofa synon të shmangë, pakësojë ose transformojë efektet e pafavorshme të rreziqeve. Natyra e ciklit DRM do të thotë që fazat e ciklit ndërthuren mes tyre. Ne përcaktojmë pesë faza të përgatitjes, reagimit, rikuperimit, zvogëlimit të rrezikut të mundshëm dhe uljes së rrezikut nëpërmjet korigjimeve të ciklit DRM.

Reduktimi i riskut nga katastrofa (DRR): Koncepti dhe praktika për zvogëlimin e rreziqeve të katastrofave përmes përpjekjeve sistematike për të analizuar dhe menaxhuar faktorët shkaktarë të katastrofave, përfshirë zvogëlimin e ekspozimit ndaj rreziqeve, zvogëlimin e cënueshmërisë së njerëzve dhe pronës, menaxhimit të duhur të tokës dhe mjedisit, dhe përmirësimin e gatishmërisë për ngjarje të papritura.

Risku i katastrofës: Humbjet e mundshme të jetës, lëndime, pasuri të shkatërruara ose të dëmtuara që mund t'i ndodhin një sistemi, shoqërie ose një komuniteti në një periudhë specifike kohore, të përcaktuar në mënyrë të mundshme si një funksion i rrezikut, ekspozimit dhe vulnerabilitetit.

Katastrofë: Shiko katastrofë përmytjeje

Sistemi i paralajmërimit të hershëm: Një sistem që u siguron njerëzve paralajmërim paraprak për një ngjarje të rrezikshme që mund të ndodhë, duke u dhënë njerëzve kohë për të mbrojtur veten, pasuritë e rëndësishme dhe shërbimet e rëndësishme.

Të dhëna empirike : Duke mbledhur të dhëna sasiore mbi dobinë e secilit burim, si dhe krahasimin e notave të aftësisë ripërtëritëse para-ngjarjes me rezultatet, studiuesit tanë shpresojnë të gjenerojnë prova se burime të caktuara të aftësisë ripërtëritëse janë kritike në kontekste të shumëfishta.

Konteksti mjedisor i mundshëm: Jashtë kontekstit të drejtpërdrejtë të ndikimit të komunitetit, aspektet mbi të cilat komuniteti nuk ka kontroll të drejtpërdrejtë, për shembull 'planifikimi i integruar i menaxhimit të përmytjeve'.

Plani i evakuimit: Marrëveshjet e vendosura paraprakisht për të mundësuar lëvizjen e njerëzve dhe pasurive përkohësisht në vende më të sigurta para, gjatë ose pas ndodhjes së një ngjarjeje të rrezikshme. Planet e evakuimit mund të përfshijnë plane për kthimin e të evakuarve dhe mundësi për t'u strehuar në vend.

Evakuimi: Lëvizja e njerëzve dhe pasurive përkohësisht në vende më të sigurta para, gjatë ose pas ndodhjes së një ngjarjeje të rrezikshme në mënyrë që t'i mbrojë ata.

Ekspozimi: Situata e njerëzve, infrastruktura, strehimi, kapacitetet prodhuese dhe asetet e tjera të prekshme njerëzore të vendosura në zona të rrezikuara. Ekspozimi i referohet njerëzve dhe asetëve të tyre (shih 'Asetet') që ndodhen në zonën e

katastrofës.

Kapitali financiar: Niveli, ndryshueshmëria dhe larmia e burimeve të të ardhurave dhe qasja në burime të tjera financiare që kontribuojnë në pasuri.

Përmbytjet e rrëmbyeshme: Përmbytjet e rrëmbyeshme shkaktohen nga ngjarje ekstreme të reshjeve ose lëshimi i papritur i ujit për një periudhë të shkurtër kohe. Ato ndodhin brenda disa minutash deri në orë pas ngjarjes së reshjeve të shiut dhe prodhojnë përrrenj të furishëm uji që lëvizin me shpejtësi të madhe. Ndërsa shumica e përmbytjeve të menjëhershme shkaktohen nga shiu i rrëmbyeshëm që bie brenda një kohe të shkurtër (si gjatë stuhive të forta), ato mund të ndodhin edhe nëse nuk ka rënë shi përmes hapjes së digave ose shkrija e akujve në zonat malore që rrjedhin me shpejtësi të madhe.

Katastrofa nga përmbytja: Një ndërprerje serioze e funksionimit të komunitetit që përfshin humbje njerëzore, materiale, ekonomike ose mjedisore, ngjarje që tejkalon aftësinë e komunitetit të prekur për të përballuar përdorimin e burimeve të veta.

Aftësia Ripërtëritëse ndaj përmbytjeve: Ne kemi konstatuar që “aftësia ripërtëritëse” është një tregues që siguron që një komunitet është në proces zhvillimi përballë rrezikut nga përmbytjet. Me fjalë të tjera, nëse një komunitet i prirur të përmbytet ka aftësi ripërtëritëse, zhvillimi i tij nuk do të ndërpritet për shkak të përmbytjes. Më konkretisht, përkufizimi që ne ndjekim nga një punim shkencor të Aleancës, përcakton Aftësinë Ripërtëritëse ndaj Katastrofës si: Aftësia e një sistemi, komuniteti ose shoqërie për të ndjekur zhvillimin e tij social, ekologjik dhe ekonomik dhe objektivat e zhvillimit, ndërsa administron rrezikun që i vjen nga katastrofat përgjatë kohës dhe duke u përforcuar njëkohësisht.

Përmbytja: Një rrjedhë e një sasive të madhe uji përtej kufijve normal, veçanërisht mbi atë që është zakonisht quhet tokë e thatë. Katër lloje të përmbytjeve janë: përmbytjet e rrëmbyeshme, përmbytjet e lumenjve, përmbytjet bregdetare dhe përmbytjet sipërfaqësore.

Diskutim në fokus grup: Një numër i të caktuar njerëzish të ftuar më parë ose para zgjedhur (idealisht jo më shumë se 20) që marrin pjesë në një bisedë të strukturuar. Diskutimi moderohet nga një nga vullnetarët ose stafi që ka punuar në terren. Për secilën pyetje mund tu drejtohesh më shumë se një fokus grupi. Fokus grupet mund të jenë grupe që ekzistojnë zyrtarisht dhe takohen rregullisht ose mund të jenë joformale dhe të thirrura posaçërisht për këtë proces, të mbledhjes së të dhënave.

Nota: Vlerësimi ndodh në nivelin e burimeve, që do të thotë se çdo burim vlerësohet me një notë ndërmjet A-D. Jepet udhëzim specifik për secilin nga burimet dhe karakteristikat e secilës notë, kjo është skema fikse që ndiqet:

A: Praktika më e mirë

B: Standard i mirë, nuk ka nevojë të menjëhershme për përmirësim

C: Mangësi, hapësirë për përmirësim të dukshëm

D: Në mënyrë të konsiderueshme nën standardin e mirë, potencialisht për humbje/dëmtime të menjëhershme

Secili burim ka një deklaratë përkufizimi ose arsyetimi për të ndihmuar vlerësuesit të kuptojë se çfarë po vlerësojnë egzaktesisht.

Rreziku: Një substancë, objekt ose situatë që mund të shkaktojë plagosje ose dëme.

Rreziku është potencial për kërcënim të jetës ose pasurisë. Për të krijuar rrezik (përmbytje), duhet të jetë i pranishëm së pari një rrezik (natyror, përmbytje), p.sh. nga lumenjtë, deti ose nga rrjedhjet e ujërave sipërfaqësore. Rreziku i përmbytjes mund të shprehet si probabiliteti i ndodhjes në një vend të caktuar dhe mund të analizohet ose identifikohet duke përdorur hartat e përmbytjes. Rreziqet mund të jenë natyrore ose jo-natyrore. Rreziqet natyrore shkaktohen nga moti, klima dhe treguesit gjeofizikë; rreziqet jo-natyrore shkaktohen nga ngjarje sociale, politike, ekonomike dhe teknologjike.

Pyetësori në familje: Një diskutim i strukturuar midis ekipeve që punojnë në terren dhe një individi nga familja, që zakonisht mbahet në shtëpinë e të intervistuarit.

Familja: Anëtarët e një familje ndajnë me njëri tjetrin të njëjtën strehë banimi dhe mbledhin një pjesë ose të gjithë të ardhurat e tyre sëbashku apo pasurinë e tyre dhe konsumojnë lloje të caktuara të mallrave apo të shërbimeve sëbashku, kryesisht akomodim dhe ushqim. Një familje mund të jetë e vendosur në një njësi strehimi (shtëpi, apartament etj) ose në një grup vendbanimesh kolektive si një konvikt, një hotel apo një kamp. Familja mund të jetë gjithashtu e pastrehë. Një familje me një person siguron ushqimin e tij ose të saj të domosdoshme për të jetuar pa përfshirë ndonjë person tjetër. Një familje me shumë persona është një grup prej dy ose më shumë personave që jetojnë së bashku, të cilët sigurojnë ushqim ose gjëra të tjera të domosdoshme për të jetuar.

Kapitali njerëzor: Dituria, edukimi, aftësitë, shëndeti i njerëzve në komunitet.

Ndikimi indirekt: Një ndikim për shkak të një ndërveprimi indirekt, ose sekondar, që përfshin ndikime si shok psikologjik ose stresi apo një komponenti fizik, ekonomik, shoqëror ose politik, ose një ndikim që rezulton kompleksiteti i disa ndikimeve njëkohësisht. Pas katastrofës, ndikimet indirekte mund të përfshijnë humbjet e biznesit që vijnë nga konsumatorët që shpenzojnë më pak për arsye sepse po rimëkëmben nga përmbytja, ose pasoja fizike indirekte nga një përmbytje për shkak të ndotjes së ujit (jo efektet që uji i përmbytjes shkaktoi drejtpërdrejt).

Institucionet: Rregullat, normat, besimet dhe konventat që formësojnë ose drejtojnë marrëdhëniet njerëzore dhe ndërveprimet, qasjen dhe kontrollin mbi burimet, mallrat dhe shërbimet, pasuritë, informacionin dhe influencën. Normat juridike janë rregullat dhe rregulloret formale të krijuara nga organet legjislative dhe administrative. Normat kulturore janë rregulla joformale, ose përvoja shoqërore dhe kulturore, që rregullojnë sjelljen njerëzore.

Intervista me persona kyç: Intervista të thelluara me njerëz që kanë njohuri të specializuara për komunitetin.

Planifikimi i territorit: Menaxhimi zyrtar i zhvillimit të territorit nga autoritetet përgjegjëse. Në rastin ideal, planifikimi i territorit duhet të sigurojë që përdorimi i tokës është efikas, etik dhe minimizon ekspozimin ndaj rreziqeve.

Mjete jetese: Një mjet për të siguruar jetesën. Ai përfshin aftësitë, të ardhurat dhe aktivitetet e njerëzve të nevojshme për të siguruar nevojat bazë përmes të ardhurave.

Margjinalizim: Margjinalizimi, i quajtur gjithashtu përjashtim shoqëror, i referohet individëve ose grupeve që zbresin në skajet e shoqërisë për shkak të mungesës së aksesit në të drejta, burimet dhe mundësitë. Margjinalizimi mund të ndodhë për arsye

kulturore ose shoqërore (të tilla si gjinia, përkatësia etnike, mosha, feja, orientimi seksual), arsye ekonomike (të tilla si njerëzit që jetojnë në varfëri ose që janë të pastrehë), ose për shkak të disavantazhit fizik (të tilla si ata që jetojnë me një paaftësi fizike, të moshuarit, njerëzit me sëmundje mendore ose varësi nga droga).

Minoritet: Çdo grup njerëzish që për shkak të karakteristikave të tyre, për shembull karakteristikave fizike ose kulturore, veçohen nga të tjerët në shoqërinë në të cilën jetojnë për një trajtim diferencial dhe të pabarabartë, dhe që për këtë arsye e konsiderojnë veten e tyre si objekte të diskriminimit kolektiv. Vini re se të qenit pakicë numerike nuk është karakteristikë e të qenit grup pakicë; nganjëherë grupe më të mëdha mund të konsiderohen grupe pakice për shkak të mungesës së tyre të pushtetit. Shpesh është mungesa e pushtetit apo e fuqisë që është karakteristika mbizotëruese e një pakice, ose grupi të varur.

Kapitali natyror: Baza e burimeve natyrore, përfshirë produktivitetin e tokës dhe veprimet që e mbështesin atë, ujin dhe burime të tjera që plotësojnë nevojat bazë dhe rrisin mirëqenien.

Mjedisi natyror: Mjedisi natyror është i përbërë nga element të gjallë dhe element përbërës jo të gjallë që ndodhin natyrshëm (nuk janë bërë nga njerëzit), përfshirë karakteristikat natyrore të tilla si lumenjtë, ekosistemet dhe shërbimet e ekosistemit që ato ofrojnë.

Strategjitë e gabuara: Nganjëherë të njohura si strategji ose mekanizma përballimi eroziv, strategjitë e gabuara për përballimin e një situatë janë ato që shkatërrojnë mirëqenien afatgjatë të një familjeje, të tilla si shfrytëzimi i paqëndrueshëm mjedisor, largimin e fëmijëve nga shkolla ose shitja e aseteve prodhuese.

Përqindja: Një përqindje është një numër ose raport i shprehur si fraksion i 100-ës, shpesh shënohet duke përdorur shenjën %. Përqindjet shpesh përdoren për të shprehur një pjesë proporcionale të një totali. Për shembull, nëse 50% e familjeve në komunitet punojnë në bujqësi, kjo do të thotë që 50 në çdo 100 familje punojnë në bujqësi; nëse ka 200 familje në komunitet, atëherë 100 prej tyre punojnë në bujqësi. Vlera e përqindjes llogaritet duke shumëzuar vlerën numerike të raportit me 100. Për shembull, për të gjetur 30 familje si përqindje e 200 familjeve totale, së pari llogaritni raportin $30/200 = 0.15$, dhe pastaj shumëzoni me 100 për të dalë 15 %.

Asetet fizike: Një aset fizik është një send që ka një ekzistencë materiale, dhe potencialisht mund të blihet ose shitet. Asetet fizike njihen gjithashtu si pasuri të prekshme. Për familjet, pasuritë fizike zakonisht i referohen një shtëpie (nëse nuk jepet me qira) dhe materialeve brënda saj, automjeteve të tilla si motoçikletat ose makinat. Për bizneset, pasuritë fizike zakonisht u referohen pronave, pajisjeve dhe inventarit/aksioneve, shih gjithashtu asetet prodhuese.

Kapitali fizik: Gjërat e prodhuara nga aktiviteti ekonomik i kapitaleve të tjera, siç janë infrastruktura, pajisjet, përmirësimet në të korra, bagëti, etj..

Studim post ngjarjes: Një studim pas ngjarjes është një matje e dokumentuar pasi një përmbajtje ndodh në një komunitet të projektit, e ngjashme me një vlerësim të ndikimit. Studimi pas ngjarjes është konfiguruar dhe zbatuar me të njëjtin proces si një studim fillestar apo T-line , megjithatë ai ka tregues të ndryshëm për tu matur në lidhje me ndikimet e përmbajtjes që ndodh.

Masa paraprake: Veprimi i ndërmarrë para se të ndodhë një përmbytje në mënyrë që të zvogëlohen ndikimet e përmbytjeve që kanë shanse të ndodhin. Veprimet paraprake ndërmerren në kohë normale, jo në momentet pak para se përmbytja të ndodhë.

Gatishmëria: Veprimet parandaluese të ndërmarra para rrezikut të një katastrofe. Në nivelin e familjes, kjo mund të përfshijë të kuptuarit e rrezikut që kanoset dhe të dini se çfarë burimesh keni dhe veprimet përgatitore që mund të ndërmerrni për të shmangur ose zvogëluar humbjet (të tilla si të ngjisësh letrat dhe pajisjet e ndryshme nga toka në një terren më të lartë kur merrni një paralajmërim për përmbytjen). Në nivelin e komunitetit, kjo mund të përfshijë vendosjen e rrugëve të evakuimit. Në nivelin e rrethit ose atë kombëtar, kjo mund të përfshijë shoqatat humanitare që paralajmërojnë shpërndarjen e ndihmave emergjente.

Asetet prodhuese: Asetet fizike të prekshme (shih asetet fizike) që përdoren për të gjeneruar të ardhura. Shembujt përfshijnë një moto-taksi, bagëti / kafshë, pajisje bujqësore ose biznesi.

Reduktimi i rrezikut të mundshëm: Veprimet e ndërmarra për të shmangur krijimin e rreziqeve të reja ose rritjen e tyre, për shembull rregulloret e ndërtimit dhe planifikimi e territorit duke shmangur ndërtimet e reja të shtëpive në vende të rrezikshme.

Shpejtësia: Aftësia për të përballuar humbjet dhe për të rikuperuar në kohën e duhur, për shembull qasja në financa të shpejta për rimëkëmbjen.

Rigjenerim: Veprimet e ndërmarra pas një katastrofe (qoftë në planet afatshkurtër apo afatgjatë) për të ndihmuar njerëzit të përballen me ndikimet e katastrofës, të rindërtojnë sistemet e dëmtuara fizike (p.sh., shtëpitë, rrugët, strukturat e dëmtuara të mbrojtjes nga përmbytjet) dhe të rivendosin shërbimet.

Mundësitë: Diversiteti funksional, për shembull mundësia e evakuimit nga rrugë të ndryshme.

Dërgesat monetare nga jashtë: Një remitancë është një transferim parash nga një person që punon jashtë komunitetit, tek një person që jeton brënda komunitetit. Paratë mund të transferohen në mënyrë elektronike ose me mjete të tjera.

Aftësi ripërtëritëse: Shiko aftësinë ripërtëritëse për përmbytjet.

Grupet e gatshme: Aftësia për të mobilizuar kur ka rrezik për shembull një grup i komunitetit i cili mund të kthejë një hapësirë në qendër të komunitetit në një strehë përmbytjesh.

Përgjigjja: Veprimet e ndërmarra gjatë dhe menjëherë pas një katastrofe për të frenuar ose zbutur ndikimet e katastrofës, duke përfshirë evakuimin, kërkim shpëtimin, ndihmën e parë dhe shpërndarjen e ndihmave ushqimore.

Risku: Shikoni. Risku i katastrofës.

Përmbytjet e lumenjve: Përmbytjet e lumenjve ndodhin kur nivelet e ujit në lumenj, liqene dhe përrenj rriten dhe derdhen në brigjet përreth dhe tokat fqinje. Rritja e nivelit të ujit mund të jetë për shkak të shiut të tepërt ose shkrires së borës.

Qëndrueshmëria: Aftësia për të përballuar një goditje, për shembull strehimin dhe urat e ndërtuara për t'i bërë ballë ujërave të përmytjes.

Kapitali social: Marrëdhëniet shoqërore dhe rrjetet, obligacionet që ndihmojnë veprimin bashkëpunues, lidhjet që lehtësojnë shkëmbimin dhe qasjen në ide dhe burime.

Burimi i aftësisë ripërtëritëse: FRMC përmban 45 'burime të aftësisë ripërtëritëse' - ose shkurt 'burime'. Secili burim është caktuar në njëren nga kategoritë e 5C, 4R, të vlerësuara nga një vlerësues i trajnuar. Burimet vlerësohen në studimet fillestare dhe ato T-line.

Përmytjet sipërfaqësore: Përmytjet sipërfaqësore ndodhin gradualisht dhe kështu njerëzit kanë kohë të strehohen ose të largohen nga zona. Niveli i ujit është i ulët në tokë (rrallë më shumë se 1 metër) dhe nuk shkakton kërcënim të menjëhershëm për jetën. Sidoqoftë, varësisht nga zona e përmytur, mund të shkaktojë dëme të konsiderueshme ekonomike. Në zonat urbane, përmytja sipërfaqësore ndodh kur ka mungesë të kullimit, që do të thotë se uji që duhej të kullonte në tokë nuk mund të kalojë nëpër sipërfaqe të shtruara, dhe kështu që të ridrejtohet në sistemin e kanalizimit dhe kullimit të stuhisë. Përmytja ndodh kur sasia e ujit që rrjedh në sistemet e kullimit i mbingarkon sistemet. Në zonat rurale, përmytjet sipërfaqësore (ndonjëherë të quajtura përmytje pluviale ose pellgje) ndodhin në zona relativisht të rrafshëta. Uji i shiut normalisht ruhet në tokë, kanale ose liqene, ose kullohet ose derdhet. Përmytja ndodh kur në sistemet grumbulluese të ujit hyn më shumë ujë sesa mund të ruhet ose mund të dale nga ky sistem. Në këtë rast, shiu është burimi i përmytjes: jo uji që vjen nga një lumë, por uji gjatë rrugës për në lumë. Krijohen pellgje të mëdha dhe kanalet mbushen dhe derdhen; gradualisht një shtresë uji mbulon tokën.

E qëndrueshme: Shfrytëzimi i aseteve ose burimeve në një normë që plotëson nevojat e së tashmes pa çënuar aftësinë e brezave të ardhshëm për të përmbushur nevojat e tyre.

Tema: Secilit burim i është caktuar një nga 7 temat. Pyetjet në sondazhe janë të organizuara nga këto tema, sepse ato janë më praktike. Të 7 temat janë pasuritë, mjetet e jetesës, mjedisi natyror, jeta dhe shëndeti, linjat jetësore, qeverisja dhe normat shoqërore.

Linja T-study: Pas linjës fillestare, zbatimet e mëvonshme të FRMC në të njëjtin komunitet.

Degë: Një degë është rrjedhë lumi që derdhet në një pellg, lumë ose në një liqen, një degë nuk derdhet drejtpërdrejt në një det ose oqean.

Faktorët nxitës themelorë të rrezikut të katastrofës: Proceset ose kushtet, shpesh të lidhura me zhvillimin, që ndikojnë në nivelin e rrezikut të katastrofës duke rritur nivelet e ekspozimit dhe cenueshmërisë ose duke zvogëluar kapacitetin e tij.

Vulnerabiliteti (i aseteve): Njihet gjithashtu si vulnerabiliteti fizik, i dallueshëm nga ndjeshmëria sociale ose ekonomike. Kushtet që rrisin ndjeshmërinë e asetit ndaj ndikimeve nga rreziku i përmytjes (shih 'Rreziku'). Vulnerabiliteti i aseteve fizike dallon

nga vendndodhja e asetëve fizik (shih Ekspozimi '). Për shembull, dy shtëpi të vendosura pranë njëra-tjetrës në një fushë përmytjeje kanë të njëjtën ekspozim, por prekshmëri të ndryshme sepse njëra është ngritur mbi këmbëza dhe tjetra jo.

Njerëzit / grupet / popullësia vulnerabël: Grupet vulnerabël mund të përcaktohen nga mungesa e aftësive për të parashikuar, përballuar, rezistuar dhe rikuperuar nga ndikimi i një rreziku natyral ose të bërë nga njeriu. Koncepti është relativ dhe dinamik. Vulnerabiliteti shpesh lidhet me varfërinë, por mund të lidhet dhe me faktin kur njerëzit janë të izoluar, të pasigurt dhe të pambrojtur përballë rrezikut, shokut ose stresit. Shembuj të grupeve potencialisht vulnerabël përfshijnë: popullatat e zhvendosura që lënë vendbanimin e tyre të zakonshëm në strehëza kolektive, zakonisht për shkak të një katastrofe apo konflikti të papritur, si një mekanizëm përballimi dhe me qëllimin për t'u kthyer; migrantët që largohen nga vendbanimi i tyre i zakonshëm për të shkuar në vende të reja; grupe specifike brenda popullatës lokale, siç janë marginalizuar (shih 'Margjinalizuar'), njerëz të përjashtuar ose të varfër; fëmijë të vegjël, gra shtatzëna dhe gjidhënese, fëmijë të pashoqëruar, të ve, të moshuar pa mbështetje familjare, persona me aftësi të kufizuara. Në një katastrofë, gratë në përgjithësi mund të preken ndryshe nga burrat për shkak të statusit të tyre shoqëror, përgjegjësive familjare ose rolit riprodhues, por ato nuk janë domosdoshmërisht vulnerabël. Ata janë gjithashtu të shkathët dhe të aftë për tu ripërtërirë në një krizë dhe luajnë një rol vendimtar në rimëkëmbje. Analiza gjinore mund të ndihmojë në grave ose vajzave që mund të jenë vulnerabël dhe pse.

The Zurich Flood Resilience Alliance is a multi-sectoral partnership focusing on finding practical ways to help communities in developed and developing countries strengthen their resilience to flood risk. Find out more: <https://floodresilience.net/zurich-flood-resilience-alliance>